


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
ZYRA E NOTERISE PESHKOPI
NR.5555 REPERTORI
NR.1795 KOLEKSIONI

NOTER PUBLIK
Ilir KRASHI
Bulevardi "Nazmi Rushiti" Peshkopi
Tel./Fax:0035521822539
Mob:0682055953



PROKURË E POSAÇME

Në qytetin e Peshkopise, sot me datë 11.07.2017 (dymijëeshtatëmbëdhjetë) ditë e marte, para meje **NOTERIT PUBLIK Ilir KRASHI**, i regjistruar në **DHOMËN E NOTERËVE TIRANË**, me zyrë në bulevardin "Nazmi Rushiti" të qytetit të Peshkopise, u paraqit personalisht, **I PËRFAQËSUARI**:

Albian Balliu, i biri i Perparim, lindur më 16.03.1996 në Pjece, Diber e banues në Peshkopi, Njesia Administrative Peshkopi, Bashkia Diber, me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar, identifikuar prej meje me kartën e identitetit me numer J60316005G, në cilësinë e **Administratorit dhe Ortakut të Shoqërisë "BALLIU-DI shpk" shpk**, pajisur me **NUIS nr.L76905701R**, me seli të shoqërisë në Diber, Peshkopi, Lagja "Gjok Doci", Rruga "Tercilio Kardinali", selia në ndërtesën me numer pasurie 13/10-N1, pranë kryqezimit, i cili kerkoi redaktimin e kesaj prokure të posaçme. Unë noteri, mbi bazën e kërkesës së tij dhe bazuar në nenin 64 e vijues, 70 e vijues të Kodit Civil, nenin 96 e vijues të Kodit të Procedurës Civile e Ligjin Nr.7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë", i ndryshuar, redaktoj këtë prokurë të posaçme, si më poshtë:

"I përfaqësuar Albion Balliu, në cilësinë e **ADMINISTRATORIT DHE ORTAKUT TË SHOQËRISË "BALLIU-DI" shpk**, deklaron para meje se emëron përfaqësues të posaçëm të tij babain e tij **PERPARIM BALLIU**, i biri i Hajrulla, lindur më 04.01.1966 e banues në qytetin e Peshkopise, zoterues i kartës së identitetit me numer G60104112S, të cilit i jep të drejta e fuqi të plota që në emër dhe për llogari të tij në cilësinë e tij si Administrator dhe Ortak i Shoqërisë "BALLIU-DI" shpk, të paraqitet pranë zyrave dhe autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme në emër dhe për llogari të tij, duke patur të drejtën që të kërkojë dhe dorëzojë çdo dokument që do të nevojitet, të drejtën e lidhjes së çdo kontrate të parashikuar me ligj në emër dhe për llogari të tij me çdo institucion publik ose privat, me çdo person fizik apo juridik, privat apo shtetëror, duke nënshkruar çdo dokument e duke kryer çdo veprim tjetër të parashikuar me ligj, duke i dhënë të drejta e fuqi të plota që t'i kryejë të gjitha procedurat në mungesë të të përfaqësuarit, duke patur njëherësh të drejtën që të paraqitet përpara çdo autoriteti dhe zyre për të kërkuar çdo dokument që ai do ta gjejë të nevojshëm, të drejtën për të paraqitur kërkesa dhe dokumente të ndryshme përpara çdo autoriteti dhe zyre, të drejtat personale të të nënshkruarit si dhe të drejtën për të kryer çdo veprim tjetër që ka lidhje me këtë përfaqësim, duke patur gjithashtu të drejtën që ai të likujdojë për llogari të tij të gjitha detyrimet që do të rëndojnë mbi të, të drejtën që të hyjë në marrëdhënie me persona të tjerë fizikë, me persona juridike, privat ose shtetërorë duke patur të drejtën që të lidhë çdo kontratë të njohur me ligj, të lëshojë deklarata, të lidhë kontrata me çfarëdo objekti dhe përmbajtjeje, të drejtën që të lidhë dhe nënshkruajë aktmarreveshje të ndryshme, deklarata noteriale, të drejtën që të nënshkruajë çdo akt apo veprim noterial përpara një zyre noterie brenda vendit, të drejtën që të paraqesë kërkesa apo ankesa për probleme që mund t'i lindin, të drejtën që ta përfaqësojë pranë autoriteteve kompetente në Bashkinë Diber, Keshillin e Qarkut Diber, Institucionin e Prefektit të Qarkut Diber, zyrave të gjendjes civile dhe pranë çdo zyre dhe autoriteti kompetent për të kërkuar dhe dorëzuar çdo dokument që do të nevojitet, të drejtën që të kryejë çdo veprim bankar pranë çdo banke të nivelit të dytë që operon në Republikën e Shqipërisë, duke kryer çdo veprim bankar dhe financiar në llogaritë e tij në cilësinë e tij si Administrator dhe Ortak i Shoqërisë "BALLIU-DI" shpk, duke patur të drejtën që të nënshkruajë në cilësinë e tij si Administrator dhe Ortak i Shoqërisë "BALLIU-DI" shpk çdo dokument e të kryejë

çdo veprim me çdo bankë dhe institucion financiar jobankë që operon në territorin e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e tij si hipotekues për çdo pasuri të paluajtshme të vendosura si garanci hipotekore për llogari të çdo banke dhe institucioni financiar jo bankë që operon në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke patur gjithashtu të drejtën që të bëjë deklarime, paraqesë dokumente, kerkojë dhe paraqesë informacione pranë çdo institucioni, të nënshkruajë aplikimet respektive, të hartojë dhe nënshkruajë kontratat e kredise, të hipotekes, dorezane, pengjeve, barreve sigurorese si nënshkrimin e çdo lloji akti tjetër të nevojshëm dhe të parashikuar me ligj, duke patur njëherësh të drejtën që me çdo autoritet dhe zyre kompetente brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të kryejë çdo veprim tjetër të nevojshëm, i cili ndonëse nuk është percaktuar shprehimisht në këtë prokurë, duhet të kryhet prej përfaqësuesit të caktuar Perparim Balliu, në funksion të realizimit të interesave të ligjshme të të përfaqësuarit Albion Balliu, duke dhënë pëlqimin që të gjitha procedurat të bëhen në mungesë të tij dhe me praninë e përfaqësuesit të caktuar prej tij, duke nënshkruar çdo dokument e duke kryer çdo veprim që ka lidhje me këtë përfaqësim, të drejtën që ta përfaqësojë pranë autoriteteve doganore, tatimore dhe QKB brenda vendit si dhe pranë çdo autoriteti dhe zyre për të kërkuar dhe dorëzuar në emër të tij çdo dokument e për të kryer çdo veprim të nevojshëm, duke kryer të gjitha veprimet e përmendura më sipër dhe veprime të tjera të cilat ndonëse nuk janë percaktuar shprehimisht në këtë prokurë, duhet të kryhen prej përfaqësuesit të caktuar në funksion të realizimit të interesave të ligjshme të të përfaqësuarit, duke i kryer këto veprime për një afat të pacaktuar, deri në revokimin e kesaj prokure nga i përfaqësuari apo deri në mbarimin e prokures me një nga menyrat e parashikuara me ligj. I përfaqësuari Albion Balliu, i konsideron të gjitha veprimet e kryera prej përfaqësuesit të zgjedhur prej tij plotësisht të drejta e të ligjshme si të kryera prej tij personalisht, meqënëse ai vetë është i pamundur për të kryer këto veprime". Kjo prokurë e posaçme redaktohet sipas vullnetit të lirë e të plotë të të përfaqësuarit Albion Balliu, të cilit pasi ju lexua nga ana ime përmbajtja e prokures e pasi u gjet në përputhje me vullnetin e tij, ai deklaroi para meje se e kuptoi dhe e pranoi atë duke e shkruar dhe nënshkruar në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj atë sipas ligjit dhe për të gjitha efektet e tij.

I PËRFAQËSUARI:

NOTERI

Shoqëria "BALLIU-DI" shpk,
përfaqësuar nga Ortaku dhe Administratori:

Albion Balliu 

NOTER
Ilir KRASHI 
Cel: +355 682055953



